



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 3 shtator, Trupi Gjykses hodhi poshtë një kërkesë të Prokurorisë për vendosjen e disa kufizimeve mbi vizitat jo të privileguara të z. Thaçi me persona të identifikuar si 'vizitorë për të cilët është ngritur shqetësim', si dhe për ndalimin e çdo diskutimi në lidhje me çështjen me vizitorë jo të privileguar.

Trupi Gjykses vuri në dukje se ka urdhëruar më parë që të gjitha vizitat jo të privileguara të z. Thaçi të miratohen paraprakisht nga Administratorja dhe se ajo duhet të refuzojë vizitat personale në qoftë se ka tregues të besueshëm se vizitori ka kryer sjellje të papajtueshme me integritetin e procesit. Trupi Gjykses theksoi gjithashtu se diskutimet e aspekteve konfidenciale të çështjes me persona jo të privileguar janë ndaluar që më parë, dhe se nuk shkaktohet dëm në qoftë se i akuzuari diskuton informacion të disponueshëm publikisht për çështjen me vizitorët e tij. Trupi Gjykses rikujtoi se të gjitha rastet kur duket se z. Thaçi u dha vizitorëve jo të privileguar informacion konfidencial ndodhën përpara urdhrit të mëparshëm për modifikimin e kushteve të paraburgimit. Për këtë arsye, Trupi Gjykses konstatoi se vendosja e kushteve shtesë të paraburgimit, përveç atyre që janë në fuqi, nuk është e nevojshme në rrethanat aktuale.

Megjithatë, Trupi Gjykses rikujtoi se pavarësisht nga të gjitha përpjekjet për mbrojtjen e dëshmitarëve, dëshmitarët në këtë çështje gjyqësore janë ankuar për tentim për ndërhyrje ose ndërhyrje. Trupi Gjykses përsëriti se ka marrë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme, në përputhje edhe me të drejtat e të akuzuarve, për të siguruar që raste të tilla të mos ndodhin më.

Më 10 tetor, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit. Trupi Gjykses konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të pengojë ecurinë e procesit dhe të kryejë vepra penale të tjera. Trupi Gjykses rikujtoi se, edhe pas dhënies së dëshmisë nga dëshmitarët e thirrur nga Prokuroria, identitetet e dëshmitarëve të mbrojtur nuk duhet të bëhen të njohura për publikun. Trupi Gjykses specifikoi se rreziqet që synohen të parandalohen me paraburgimin përfshijnë tentimin për hakmarrje ndaj dëshmitarëve që kanë dhënë dëshmi në proces, si dhe tentimet për t'u dhënë atyre motivin për ta tërhequr dëshminë. Trupi Gjykses theksoi se procesi në lidhje me pretendimet për ndërhyrje në çështjen aktuale është në kryerje e sipër.





Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është caktuar për të hënë, 27 tetor, duke filluar në orën 9:00 paradite.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Isni Kilajt, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, në lidhje me pretendime për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, më 10 tetor, Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi Prokurorinë, Mbrojtjen dhe Administratoren të rishikojnë parashtrimet e protokolluara që aktualisht janë të klasifikuara si konfidenciale, dhe të japin shpjegim përse duhet të mbesin konfidenciale; ose të kërkojnë riklasifikimin e tyre si “publike”, ose të dorëzojnë versione të redaktuara publike të tyre jo më vonë se të premtën, 24 tetor 2025. Gjithashtu, ajo ftoi palët dhe Administratoren të bashkërendojnë mes tyre, nëse është e nevojshme, për të siguruar përputhje në redaktimet që do të zbatohen në parashtrimet përkatëse.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake vuri në dukje se procedura paraprake në këtë çështje është në përfundim, dhe se synon t’ia kalojë çështjen trupit gjykues në gjysmën e parë të nëntorit, përveç nëse vendimet që do të jepen nga Paneli i Gjykatës së Apelit do të bëjnë të nevojshme përshtatjen e afatit. Për të përgatitur kalimin e çështjes dhe duke mbajtur parasysh parimin që procedurat të jenë publike, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e gjykoi të nevojshme që të bëhet rishikimi i klasifikimit të parashtrimeve.

